



UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. Nr. 1727/24

Pejë, 08.07.2024

Senati i Universitetit "Haxhi Zeqa" në Pejë në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 102, të Statutit të Universitetit, në mbledhjen e mbajtur me 08.07.2024 dhe në bazë të vendimit të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit Ref. Nr.01B/1850 datë 05.07.2024, miratojë propozimet e njësive akademike për shpalljen e:

KONKURSI
për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore- Bachelor në vitin
akademik 2024/2025

Fakulteti i Biznesit – Bachelor

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
MMB	Menaxhim Biznesi – gjuhë shqipe Modulet: 1.Banka dhe Financa 2.Administrim Biznesi	150	125	18	7
MMBb	Menaxhim Biznesi – gjuhë boshnjake Modulet: 1.Banka dhe Financa 2.Administrim Biznesi	50	41	6	3
TIBE	Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi	120	100	14	6

Provimi pranues në programin Menaxhim Biznesi mbahet nga lëndët: Bazat e Biznesit, Hyrje në Informatikë dhe Matematikë.

Në programin Teknologji Informacioni në Biznes dhe Ekonomi mbahet nga lëndët : Hyrje në Informatikë, Bazat e Biznesit dhe Matematika për ekonomistë.

Fakulteti Juridik

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
JP (1)	Juridik i Përgjithshëm	100	83	12	5

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës dhe Edukatë Qytetare

Fakulteti i Menaxhmentit në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis - Bachelor

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
MTHM (4)	Menaxhment në Turizëm, Hotelieri dhe Mjedis Modulet: 1. Menaxhment në Turizëm dhe Hotelieri 2. Menaxhim i Mjedisit	50	41	6	3

MTHGJB (2)	Menaxhment në Turizëm (gjuhë boshnjake)	30	24	4	2
------------	---	----	----	---	---

Provimi pranues mbahet nga lënda: Hyrje në turizëm

Fakulteti i Agrobiznesit - Bachelor

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
TPB (2)	Teknologji e Prodhimit Bimor	50	41	6	3
AA (1)	Agromjedis dhe Agroekologji	50	41	6	3
TU (3)	Teknologji Ushqimore	60	50	7	3

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji

Fakulteti i Arteve - Bachelor

Kodi i programit	Programi	Gjithsej	Për studime të rregullta	Komunitet jo shumicë 12%	Kandidatë nga Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanoci dhe Medvegja 5%
------------------	----------	----------	--------------------------	--------------------------	--

EAI (5)	Edukim Artistik në Interpretim Modulet: Harkor (Violinë, Violë, Violonçelë, Kontrabas) * Frymore (Flautë, Klarinet, Fagot, Saksofon, Trumpet, Trombon, Obo) * Solokendim * Piano, Kitare	20	17	2	1
---------	--	----	----	---	---

Në programin Edukim Artistik në Interpretim mbahet nga lëndët: Instrumenti përkatës dhe Teori Muzike.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në vitin e parë të studimeve themelore – Bachelor, në konkursin plotësues për vitin akademik 2024/2025, do të regjistrojë **680** studentë të rregullt.
2. Në kuadër të numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 të MASHTI-it, Universiteti do të regjistrojë deri në 12%, përkatësisht deri në **81** studentë të rregullt nga komuniteti jo shumicë. Kuota prej 12% e vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale, sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin program të fakulteteve veç e veç.
3. Në programet që ofrohen në gjuhën boshnjake, 12% e numrit të përgjithshëm sipas pikës 2 do të pranohen kandidatë nga komunitetet tjera jo-shumicë.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHTI, në kuadër të numrit të përgjithshëm të studentëve, mund të regjistrohen deri në 5%, përkatësisht deri në **36** kandidatë nga: Shqipëria, Maqedonia e Veriut, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja dhe Mali i Zi. Kandidatët, të cilët kanë lindur në vendet e sipërshënuaram, ndësa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
5. Përrjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
6. **Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë rezervon të drejtën e pranimi të kandidatëve me nevoja të veçanta.**

7. Të drejtë pranimi në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët e kanë përfunduar me sukses shkollën e mesme në Kosovë dhe e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
8. Në Universitet mund të pranohen edhe studentët nga shtetet e tjera, me kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
9. Njohja e diplomave për institucionet jashtë Kosovës do të verifikohet në bazë të vendimit për njohje/nostrifikim të diplomave të lëshuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës.

Vërejtje: Studentët e huaj të pranuar me rastin e regjistrimit duhet të posedojnë vendimin e MASHTI-t për njohje të diplomës.

10. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi.
11. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
12. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës, konsiderohet vepër penale, "çdo kandidatë që mbi bazën e deklaramit të rrejshëm, apo dokumentacionit të falsifikuar ka arritur të pranohet në mënyrë të padrejtë në Universitetin "Haxhi Zeka" në Pejë, do të përjashtohet në mënyrë automatike nga Universiteti "Haxhi Zeka" në Pejë, në momentin e vërtetimit të një fakti të tillë.
13. **Kandidatët, të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UHZ pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.**
14. **Kandidatët për pranim si student të UHZ-së në vitin akademik 2024/2025 nuk mund të konkurojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.**

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kriterëve si në vijim:

a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës:

- Numri maksimal i pikëve sipas kriterëve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.

- b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës:**
Numri maksimal i pikëve sipas kriteve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
- Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
- Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
- Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. **Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
 3. **Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.**
 4. **Përgjithësisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës II, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kriteve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.**
 5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
 6. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
 7. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve, të cilët kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.
 8. Për funksionimin të programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.
 9. Nëse numri i pikëve të disa kandidatëve të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet sipas këtij prioriteti:
 - a. Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta;
 - b. Kandidati/ja i/ cili/a ka sukses më të mirë të shkollës së mesme, e nëse edhe pikët e provimit pranues dhe të suksesit të shkollës së mesme janë të njëjta;
 - c. Kandidati/ja i/ cili/a ka rezultat më të mirë nga testi i maturës.
 - d. Në qoftë se edhe suksesi është i njëjtë, atëherë përzgjedhja e kandidatit/es fitues, do të bëhet përmes tërheqjes së shorti në prani të kandidatëve me pikë të barabarta si në paragrafët a), b) dhe c) të pikës 9.
 10. Regjistrimi i studentëve të pranuar në vitin e parë bëhet në Administratën Qendrore të Universitetit, sipas orarit të përcaktuar me këtë konkurs.

III. AFATET E KONKURSIONIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **08.07.2024** deri më **25.07.2024** nga ora 09:00 deri 15:00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të ditës së diel).
2. **Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
 - a. *Certifikatën/ekstraktin e lindjes (origjinal),*
 - b. *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose publikatë),*

- c. Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (original, të noterizuar ose dublikatë),
 - d. Kopjen e letërnjoftimit,
 - e. Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: **Vegza (<https://apliko.unhz.eu>) për konkurrim online përmes Internetit është: apliko.unhz.eu**
 - f. Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.
3. **Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 2 t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve përkatëse.**
 4. Dokumentet nën pikën b) dhe c) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohen me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. **P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet vepër penale.**
 5. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

Provimi pranues do të mbahet më 26.07.2024 sipas orarit si në vijim:

1. Fakulteti i Biznesit **26.07.2024** fillon në ora **10.00**
2. Fakulteti Juridik **26.07.2024** fillon në ora **10.00**
3. Fakulteti i MTHM **26.07.2024** fillon në ora **10.00**
4. Fakulteti i Agrobiznesit **26.07.2024** fillon në ora **10.00**
5. Fakulteti i Arteve **26.07.2024** fillon në ora **09.00**

Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë njërin nga këto dokumente identifikuese: letërnjoftim, pasaportë apo patentë shofer, pa njërin nga të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues.

Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!

7. **Shpallja e rezultateve preliminare të provimit pranues do të bëhet, më së voni deri më 26.07.2024 në ueb-faqen e fakultetit përkatës. Shpallja e rezultateve përfundimtare do të bëhet më 31.07.2024.**
8. Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale/noterizuara nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.

IV. E DREJTA E ANKESËS DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve (llogaritën ditët e punës). Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
2. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës më **05.08.2024**.
3. **Në programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
4. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.unhz.eu

V. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi dhe fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet më 01.08.2024 dhe 02.08.2024 në objektin e Fakultetit Juridik.**
2. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më 05.10.2024, në ora 15:00. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen për shkak të mbylljes së Sistemit për Menaxhimin e Informacionit të Arsimit të Lartë (SMIAL), prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.**
3. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili merret me rastin e regjistrimit,